



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 880 Prot.

Tiranë, më 06 07 2018

VENDIM Nr. 120, datë 27.06.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi HEC "Antena" në përroin Zalli i Shtamës, Fshati Frankth, Rrethi Mat, Qarku Dibër*-subjekti "DERBI-E" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova dhe relacionin e DRKK Shkodër në lidhje me zhvillimin e këtij projekti,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi HEC "Antena" në përroin Zalli i Shtamës, Fshati Frankth, Rrethi Mat, Qarku Dibër*-subjekti "DERBI-E" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova dhe relacionin e DRKK Shkodër në lidhje me zhvillimin e këtij projekti.
2. Subjekti "DERBI-E" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtimi HEC "Antena" në përroin Zalli i Shtamës, Fshati Frankth, Rrethi Mat, Qarku Dibër, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO